

Presidenti i zgjedhur: Aleksandër Vuçiç

Vende në Asamblenë kombëtare (250 vende): 110 vende SNS, 38 vende UZPS, 31 vende Ivica Daçiç dhe 71 vende për partitë e tjera të vogla<sup>1</sup>

Asambleja e qytetit të Beogradit (110 vende): 48 vende SNS, 26 vende UZPS dhe 36 vende për partitë e tjera të vogla<sup>2</sup>

<sup>1,2</sup>Të dhëna paraprake të publikuara nga Komisioni Zgjedhor i Republikës së Serbisë



## REZULTATET E ZGJEDHJEVE NË SERBI 2022

Republika e Serbisë mbajti zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare (si dhe zgjedhjet lokale në 14 qytete dhe komuna, duke përfshirë qytetin e Beogradit) më 3 prill 2022.

Në qendrat e votimeve janë vërejtur parregullsi të ndryshme. Incidentet janë shkaktuar për shkak të pretendimeve për regjistrime paralele të votuesve dhe presion mbi ekipet vëzhguese duke përfshirë dhe konfrontime fizike si psh incidenti në Krushvec, i cili është zgjidhur pas ndërhyrjes së policisë.

Anëtarët e Komisionit të Zgjedhjeve morën vendimin për ri-votim në disa prej qendrave të votimeve për të cilat u anulua votimi për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Ri-votimi do të bëhet të shtunën, më 16 prill 2022.

Sipas kushtetutës së Serbisë, qeveria e re duhet të formohet brenda 90 ditëve nga betimi i parlamentit.

Pjesëmarrja në zgjedhje në nivel kombëtar ishte 58.63%. Numri i fletëve të votimit të dala nga qendrat e votimit ishte 3.681.561, nga të cilat numri i fletëve të pavlefshme përbënin 2.38% për zgjedhjet presidenciale. Për zgjedhjet parlamentare fletët e votimit ishin 3.675.064 nga të cilat 2.98% rezultuan të pavlefshme.

📍 Rr. "Ibrahim Rugova", Nr. 20, Tiranë, Shqipëri

✉ [fondacioni.gemalstafa@gmail.com](mailto:fondacioni.gemalstafa@gmail.com)

🌐 <https://fq.s.al/>

Në zgjedhjet presidenciale, Aleksandër Vuçiç, presidenti aktual i Serbisë u zgjodh për një mandat të dytë me një fitore të qartë duke mbledhur 59% të votave. Vuçiç ishte kandidati i përbashkët presidencial i koalicionit të Partisë Progresive Serbe (SNS), Partisë Socialiste të Serbisë (SPS) dhe Aleancës së Hungarezëve të Vojvodinës (VMSZ). Kandidati i opozitës me të cilin Vuçiç pati garën më të fortë ishte gjenerali i ushtrisë në pension, Zdravko Ponosh, i cili morri 18% të votave.

Në zgjedhjet parlamentare, megjithatë, koalicioni i SNS -s nën listën zgjedhore "Së bashku mund të bëjmë gjithçka" mundësoi vota mjaftueshëm për të qënë partia më e madhe në parlament me rreth 43% të votave (rreth 110 vende) por këto vota nuk i sigurojnë shumicën e përgjithshme në Asamblenë Kombëtare.

Koalicioni UZPS, mbështetës i kandidatit për president Zdravko Ponosh, nën listën zgjedhore "Të bashkuar për fitore" u rendit i dyti duke siguruar 14% të votave (rreth 38 vende). Ivica Dačić me koalicionin e tij u rendit si partia e tretë më e madhe me 11.5% të votave. Një koalicion tërësisht i së majtës së gjelbër hyri në parlament për herë të parë duke sinjalizuar interesin publik në rritje për problemet mjedisore në vend.

Në zgjedhjet lokale, Beogradi votoi 38% për koalicionin e partisë SNS dhe 21.3% për koalicionin UZPS "Serbia e Bashkuar" duke bërë që SNS të humbas shumicën qeverisëse në Beograd.

Presidenti i zgjedhur, Aleksandër Vuçiç, erdhi në krye të Partisë Progresive të Serbisë në vitin 2012. Për periudhën 2012-2014, shërbeu në qeveri si Ministër i Mbrojtjes. Pas marrjes së shumicës parlamentare në 2014 deri në 2017 Vuçiç shërbeu si Kryeministër i Serbisë. Në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2016, SNS humbi shumicën parlamentare por mbeti partia më e madhe në qeveri duke fituar 93 prej 250 vendeve të Asamblesë Kombëtare. Në vitin 2020 nën drejtimin e Vuçiç, SNS rifitoi shumicën parlamentare për shkak dhe të bojkotit të zgjedhjeve nga opozita. Kandidatura e parë për president ishte në vitin 2017, ku fitoi në raundin e parë me 55% të votave.

Në deklaratën për media, Vuçiç u shpreh se ishte krenar për rezultatet e zgjedhjeve të partisë dhe veçanërisht për faktin se pas Nikola Pasiç<sup>3</sup>, ai do të jetë politikani serb që ka qënë më gjatë në pushtet në Serbi.

<sup>3</sup> Kryeministri serb dhe jugosllav në fillim të shekullit të 20-të.